

VENDIM
Nr. 350, datë 5.6.2024

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 199, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN TE BASHKITË TIRANË DHE KRUIË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESTA (PALLAT)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 199, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “...sipas anekseve 1 dhe 2...” zëvendësohen me “...sipas anekseve 1, 2 dhe 3...”.

b) Pas aneksit 2, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shtohet aneksi 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE TË PËRFUNDUARA NË ZONËN “5 MAJ” (TË KOLAUDUARA)

Nr.	Emërtimi i kontratës	Vlera e objektit sipas kontratës (ndërtim + montim + projektim)	Vlera e situacionit përfundimtar (ndërtim + montim) (pjesa e mbetur)	Vlera e studim projektimit	Vlera e mbikëqyrjes së punimeve	Vlera e kolaudit të punimeve	Vlera totale	Sipërfaqe total ndërtimi (m ²) (pjesa e mbetur)	Sipërfaqe banimi ap. (m ²)	Sipërfaqe e njësisve të shërbimit	Sipërfaqja e katit -1	Hapësirë e përbashkët (kat -1 + kat përdhe + kate banimi + kafaz ashensor+ pandus+pasazh)	Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	Total apartamente (Nr)
1	Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 15A (Seksioni 3) (pjesa e mbetur)	545,660,000	294,118,087.00	10,000,000.00	4,563,792	200,100.00	308,881,979	9,454.23	3,992.30	1,171.80	2,048.09	2,242.04	5	17	14	36
2	Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e pallatit 19 (pjesa e mbetur)	408,825,570	211,528,287.00	16,615,510.00	3,526,687	150,500.00	231,820,984	5,596.70	1,878.80	1,160.70	2,011.20	546.00	4	16	8	28
TOTALI		954,485,570	505,646,374	26,615,510	8,090,479	350,600	540,702,963	15,051	5,871	2,333	4,059	2,788	9	33	22	64

Shënim. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 199, datë 6.4.2022, “Për kalimin te bashkitë Tiranë dhe Krujë të njësisve të banimit në ndërtesa (pallat), janë kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë 26 apartamente për godinën 15A (Seksioni 2), 28 apartamente për godinën 15A (Seksioni 3) dhe 32 apartamente për godinën 19.